

Procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve!

Procedurat e regjistrimit dhe transferimit në ciklin e parë të studimeve në SH.P.A.L. “Universiteti Metropolitan Tirana”.

Për t'u pranuar në një program studimi të ciklit të parë, kandidati duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore.

Kandidati fiton statusin e studentit dhe ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik, nëse regjistrohet në sekretarinë mësimore të Universitetit brenda afateve kohore të përcaktuara paraprakisht dhe të SH.P.A.L.lura.

Për tu regjistruar, kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës dokumentacionin e nevojshëm si më poshtë:

1. Diploma e Maturës Shtetërore e noterizuar.
2. Certifikata e listës së notave e noterizuar.
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
4. Dy fotografi
5. Faturën e pagesës së tarifës së regjistrimit.

Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri. Të pranojë kushtet e përcaktuara në Statutin, Rregulloren dhe Kontratën e Studimit të SH.P.A.L. “Universiteti Metropolitan Tirana”.

Procedurat e transferimit në ciklin e parë të studimeve në SH.P.A.L. “Universiteti Metropolitan Tirana”.

Për tu regjistruar, kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të fakultetit përkatës dokumentacionin e nevojshëm si më poshtë:

1. Plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe “syllabuset” përkatëse origjinal.
2. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
3. Kopje të noterizuar të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikaten e notave, ose të një dëftese/diplomë tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të në Shqipëri dhe të njohur nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR).
Kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, duhet të paraqesë, dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
4. Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
5. Dy fotografi personale.
6. Faturën e pagesës së tarifës së regjistrimit.

Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri. Të pranojë kushtet e përcaktuara në Statutin, Rregulloren dhe Kontratën e Studimit të SH.P.A.L. “Universiteti Metropolitan Tirana”.